



---

# MANUAL I PËRDORIMIT

**Kërkesë per konsultime në SEMS**

## HYRJE

Pasi të jemi kyçur në SEMS, klikojmë në menynë **Kërkesat**, pastaj klikojmë në nën menynë **Konsultimet**.




Figura 1: Pamja kryesore

Pasi të kemi klikuar në nën menynë **Konsultimet** atëherë na paraqitet përmbajtja e kësaj menye sikurse në figurën më lartë.

Pasi të zgjedhim lëndën në të cilën dëshirojmë që të mbajmë konsultime, klikojmë në butonin



Pasi të klikojmë në butonin



na paraqiten kërkesat tona që i kemi bërë, si dhe butoni



i cili mundëson regjistrimin e kërkesës për konsultime, si në figurën më poshtë.





Figura 2: Menyja Konsultimet

Pra, për të regjistruar kërkesë për konsultime, klikoni butonin , i cili hap një modal si në figurën më poshtë.





Figura 3: Regjistrimi i kërkesës për konsultime

Në këtë modal ju paraqitet emri i profesorit së lëndës përkatëse, si dhe nje fushë ku duhet të shkruani arsyen për të cilën kërkon konsultime në lëndën përkatëse.

Pasi të plotësoni arsyen, klikoni në butonin  , dhe ju me sukses keni gjeneruar kërkesë për konsultime, dhe do ju hapet pamja si më poshtë.



Lënda	Profesor	Data e konsultimeve	Linku
Matematika 2	Profesori test	E pa shqyrtuar nga profesori	E pa shqyrtuar nga profesori

Figura 4: Përfundimi i regjistrimit të kërkesës

Siç shihet në figurë, ju do të njoftoheni që keni parashtruar me sukses kërkesën dhe se do të njoftoheni kur kërkesa të jetë shqyrtuar nga ana e profesorit.

Po ashtu, siç shihet në figurë, tabela përmban Emrin e lëndës, Profesorin, datën e konsultimeve dhe linkun ku do të mbahen konsultimet online.

Pasi që kërkesë të jetë shqyrtuar nga ana e profesorit, i cili mund të refuzoj apo të aprovoj kërkesën tuaj për konsultime, ju do të njoftoheni në e-mail për shqyrtimin e kërkeses si në figurën më poshtë:




Figura 5: E-mail njoftimi rreth kërkesës

Pra, siç mund ta shihni në e-mailin njoftues ju duhet të hyni në sistem tek menyuja **Konsultimet**, të kërkonti lëndën në të cilën keni bërë kërkesën, dhe pastaj ju paraqitet pamja si më poshtë:




Figura 6: Kërkesa e shqyrtuar

Pra, siç mund ta shihni në figurë, tani na paraqitet data e konsultimeve, si dhe linku ku do të mbahen konsultimet. Për të hyrë në konsultime mjafton të klikoni butonin [Hyr në konsultime](#), dhe do të ju hapet linku ku do ti mbani konsultimet.